

INICIATIVAT

KLIENTI

SI PRIORITET

ME DESHIREN PER T'JU OFRUAR SHERBIM ME TE MIRE, JU FTOJME TE NA TREGONI DICKA ME SHUME RRETH VETES. DUKE PLOTESUAR PYETESORIN E SHKURTER 'NJOHURI PER KLIENTET' MUND TE PERFITONI DISA DHURATA SIMBOLIKE.

I Nderuar Klient,

Qëllimi i Bankës sonë është që të vërë klientin në qendër të iniciativave të ndërmarra. "Revolucioni dixhital" ka ndryshuar sjelljen e konsumatorëve: klientët tashmë presin gjithnjë e më shumë një marrëdhënie më të ngushtë me Bankën, më të shpejtë, përgjigje në kohë reale dhe për më tepër me njohuri më të thella teknike. Përvoja juaj me Bankën tonë është shumë e rëndësishme për ne në ISBA.

Ju po e merrni këtë mesazh elektronik, sepse ne dëshirojmë të mësojmë më shumë rreth jush, dhe të identifikojmë mënyra të cilat mund t'ju ndihmojnë për të rritur më së miri vlerat e marrëdhënies sonë si dhe t'i aplikojmë këto njohuri për t'ju ofruar një shërbim më të mirë.

Për këtë arsye Banka ka hartuar një pyetësor: 'Njohuri ndaj Klientit', të gjendur në çdo degë të Bankës tonë:

- ▶ Pranë arkës, ndërkohë që prisni të kryeni veprimet tuaja bankare
- ▶ Pranë shërbimit me klientin, ndërkohë që prisni të firmosni një kontratë me Bankën.

Ju ftojmë ta plotësoni këtë pyetësor gjatë qëndrimit tuaj në Bankë ose mund ta merrni me vete ndër dokumenta të tjera të Bankës dhe ta dorëzoni të plotësuar gjatë vizitës suaj të ardhshme në degët tona. Plotësimi i tij kërkon rreth 5-10 minuta kohë.



Në shenjë falenderimi, Intesa Sanpaolo Bank Albania do të shpërblejë me dhurata simbolike 5 (pesë) klientët e parë të çdo dege, të cilët e dorëzojnë pyetësorin 'Njohuri për Klientët' brenda muajit Prill 2015.

Ne ju sigurojmë se çdo informacion i deklaruar nga ju do të jetë konfidencial dhe nuk do të ndahet me asnjë person apo institucion tjetër.

Ju falenderojmë paraprakisht për kohën dhe bashkëpunimin tuaj!

Faleminderit që zgjodhët Intesa Sanpaolo Bank Albania!